

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.01.2023*

18.01.2023  
Ora 11:09

**RENDI I DITËS**

**Projektudhëzimi “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet e qeverisjes vendore”.**

**PJESËMARRJA :**

- **KQZ**
  1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve      **Z. Ilirjan Celibashi**
  2. Stafi KQZ:                                      **Z. Y. Merkaj, Znj. M. Koja,  
Znj. P. Doçaj, Z. K. Puleri**
- **Parti Politike:**
- **OJQ:**                                              **KRIK**

**Z. I. Celibashi:** Në seancën e sotme publike kemi në rend dite këto çështje:  
Projektudhëzim “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet e qeverisjes vendore”.

Pika 2. Projektvendimi “Për përdorimin e kodeve të sigurisë për pajisjen elektronike të votimit dhe numërimit elektronik të zgjedhësve”.

E mbartuar, projektvendimi “Për përcaktimin e rregullave për raportimin financiar vjetor të partive politike, miratimin e formatit të standardizuar për raportimin financiar të partive politike gjatë vitit kalendarik, kontrollin, verifikimin e financimeve dhe shpenzimeve të tyre, si dhe mënyrën e pagesës së audituesve ligjorë”. Këtë pikë përsëri do ta shtyjme sepse akoma nuk kemi një konkludim të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.01.2023*

plotë me të interesuar shoqërinë civile, posaçërisht me KRIIK në lidhje me përmbajtjen e këtij projektakti.

Fillojmë me pikën e parë, që ka të bëjë me përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit për zgjedhjet e qeverisjes vendore”.

**Z. Y. Merikaj:** Kodi Zgjedhor në nenit 67, pika 1, 2 dhe 3 parashikon për zgjedhjet e organeve vendore, kandidatët për kryetarë bashkie dhe listat e kandidatëve për anëtarë të këshillave bashkiake, regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore ose në KQZ në ato njësi ku territori mbulohet në më shumë se një KZAZ. Neni 72 i Kodit Zgjedhor përcakton detyrimin e KQZ-së për miratimin e formatit të dokumentacionit të kandidimit. Të drejtën e regjistrimit si subjekt zgjedhor, përsëri sipas përcaktimeve të nenit 70 të Kodit Zgjedhor e kanë dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Për regjistrimin e subjekteve zgjedhore sipas këtyre dispozitave nevojitet që partitë politike, koalicionet zgjedhore, kandidatët e propozuar nga zgjedhësit të plotësojnë dokumentacionin e kandidimit sipas përcaktimit të nenit 72, pika 2 e Kodit Zgjedhor. Neni 68, pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se kandidatët për zgjedhjet e qeverisjes vendore të paraqitur nga partitë politike të cilat nuk zotërojnë asnjë mandat në kuvend, ose si kryetar bashkie, apo si anëtar i këshillit bashkiak përkatës, duhet të mbështeten nga jo më pak se 1% e zgjedhësve të kësaj zone zgjedhore, në çdo rast jo më shumë se 3000 zgjedhës dhe jo më pak se 50 zgjedhës. Bën përjashtim nga ky rregull koalicioni ku partitë pjestare, zotërojnë bashkërisht në kuvend një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëmarrëse të koalicionit, ose kur zotëron në këshillin e bashkisë përkatëse një numër mandatesh jo më të vogël se numri i partive pjesëmarrëse të

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.01.2023*

koalicionit. Neni 70 parashikon se një grup zgjedhësish mund të propozojnë kandidatë për kryetarë bashkie, ose kandidatë për anëtarë këshilli të bashkisë. Për paraqitjen e kandidatëve për zgjedhje, krijohet një komitet nismëtar i përbërë nga nëntë zgjedhës të zonës zgjedhore përkatëse. Komiteti nismëtar krijohet për organizimin e punës për mbledhjen e nënshkrimeve që do të mbështesin kandidimin. Sipas nenit 71 të Kodit Zgjedhor, për mbledhjen e nënshkrimeve KQZ-ja duhet të miratojë dhe të pajisë subjektet zgjedhore të interesuara me formularin tip për mbledhjen e nënshkrimeve. Bashkëlidhur formularit për çdo zgjedhës, depozitohet fotokopja e letër njoftimit të vlefshme e nënshkruar nga zgjedhësit. Përfshihet nga detyrimi i mësipërm kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, në qoftë se janë kryetarë bashkie, anëtarë të këshillit bashkiak përkatëse, ose deputetë. Për të verifikuar plotësimin, ose përjashtimin e këtij detyrimi ligjor, dokumentacioni i kandidimit në çdo rast duhet të shoqërohet me një vërtetim për zotërimin e mandatit, ose dhe me çertifikatën e lindjes. Komisionet Zonale të Administrimit Zgjedhor në bazë të nenit 33, germa “f” për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kanë kompetencën të regjistrojnë subjektet zgjedhore dhe kandidatët për zgjedhje. Në zbatim të kësaj kompetence KZAZ-ja do të marrë vendimit përkatëse. KQZ-ja në kuadër të unifikimit të dokumentacionit të punës së KZAZ-ve, duhet të miratojë dhe vendimet përkatëse për regjistrimin, ose sipas rasteve për mosregjistrimin e kandidatëve për organet e qeverisjes vendore. Për përmbushjen e detyrimeve ligjore për sa më sipër, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023 është hartuar seti i dokumentacionit të kandidimit i përbërë nga:

Modeli KQZ-04-01, “Formular për mbledhjen e nënshkrimeve” të zgjedhësve për mbështetje kandidati”;

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.01.2023*

Model KQZ-04-02 “Deklarata e angazhimit solemn e kryetarit të partisë politik” mbi angazhimin solemn për refuzimin për të marrë pjesë në praktika të blerjes së votës, marrjes së financimeve apo përfitimeve të kundërligjshme”;

Model KQZ-04-03, “Deklaratë për hapje llogarie të posaçme bankare të partisë politike”;

Model KQZ-04-04, “Kërkesë për regjistrimin e Komitetit Nismëtar”;

Model KQZ-04-05, “Kërkesë për regjistrimin e kandidatit të propozuar nga zgjedhësit”;

Model KQZ-04-06 “Kërkesë për regjistrimin e kandidatit për kryetar bashkie”;

Model KQZ-04-07 “Kërkesë për regjistrimin e listës shumemërore për anëtarë të këshillit bashkiak”;

Model KQZ-04-08 “Deklaratë e kandidatit për hapje llogarie bankare të posaçme”;


Model KQZ-04-09 “Deklaratë për pranimin e kandidimit”;

Model KQZ-04-10 “Jetëshkrimi i kandidatit”;

Model KQZ-00-31 “Procesverbal i dorëzimit të dokumentacionit të kandidimit”.

Ky udhëzim paraqitet për miratim pas konsultimit të tij me të gjitha grupet e interesit, rekomandimet e të cilave janë marrë në konsideratë nga Komisioneri Shtetëror Zgjedhor brenda kufijve dhe hapësirës që Kodi Zgjedhor dhe aktet në fuqi ia lejojnë. Pas rekomandimeve të KRIIK-ut është shtuar dhe jetëshkrimi i kandidatit. Gjithashtu dhe rekomandimi për hapjen e një llogarie të posaçme është përcaktuar te modelet e kandidimit. Rekomandimi për mekanizmat e kësaj llogarie të posaçme para se të hapet llogaria, mendojmë se duhet bërë pjesë e një akti tjetër dhe të mos jetë te ky akt. Bashkëlidhur keni projektudhëzimin për shqyrtim dhe miratim si dhe modelet e kandidimit, faleminderit!

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*






*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.01.2023*

**Z. I. Celibashi:** Mirë, faleminderit! Ajo çfarë vlen të theksohet, thënë shkurt, lidhet me rikonceptimin e dokumenteve dhe modeleve të kandidimit, me qëllim për ti bërë më të qarta për përdoruesit e tyre, kandidatë për kryetarë bashkie, kandidatë për anëtarë të këshillit bashkiak, parti politike, komitete nismëtare etj. Nga ana tjetër për të unifikuar sistemin e kodifikimit të këtij dokumentacioni. Shpresojmë që të jetë kështu siç e kemi menduar ne dhe për partitë politike dhe kandidatët, vërtetë. Ndoshta pas kësaj do të duhet të komunikojmë me partitë politike për t'i bërë me dije nëpërmjet faqes së internetit të KQZ-së e kanë më të thjeshtë për t'i plotësuar. Është rekomandim nga ne që plotësimin e këtij dokumentacioni ta bëjnë në faqen e internetit të KQZ-së dhe pas saj t'i printojnë, se kështu do të ketë më qartësi në përmbajtjen e këtij dokumentacioni. Mirë dakord!

**Udhëzimi nr. 1**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.18.01.2023*

Zgjedhjeve përsa parashikon kjo dizpozitë krahas materialeve zgjedhore dërgon në KZAZ, mjete të tjera të nevojshme sensitive për procesin e votimit, sikurse janë dhe kodet e sigurisë që janë të pajisura me “QR barcode”, të cilat sigurojnë integritetin e materialeve zgjedhore që do të përdoren për identifikimin e zgjedhësve si dhe administrimin e të dhënave të votuesve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe modelet e kodeve që do të përdoren për paisjet e identifikimit PEI, falemindrit!

**Z. I. Celibashi:** Mirë, atëherë e miratojmë dhe projektaktin sipas draftit të paraqitur në lidhje me kodet e sigurisë që do të përdoren në paisjen elektronike të votimit dhe identifikimit. Pikën e tretë do ta shtyjme për mbledhjen e radhës. Çështje të tjera nuk kemi!? Mirë, seanca mbyllet, faleminderit!

**Vendimi nr. 15**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

